



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 154/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazic dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK) dega në Ferizaj, për shkak të fillimit të fushatës para datës së caktuar për fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

VENDIM

HIDHET si e palejuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Ferizaj.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më dt. 03.10.2013, nga subjekti politik PDK, me të cilën pretendohet se me 02.10.2013 duke filluar nga ora 21:00 deri 23:30 në Ferizaj, në rrugët “Vëllezërit Gërvalla”, “Kadri Zeka”, “Reçakut”, “Bopam e Gursel Sylejmani” dhe “Naim Beka”, subjekti politik LDK pa kërkuar leje nga organet kompetente ka shfrytëzuar hapësirën publike duke vendosur poster të kandidatit për kryetar komune nga radhët e LDK-së para fillimit të fushatës zgjedhore. Parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e rregullave të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike . Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi .

PZAP-i në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 04.10.2013 për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik, dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri me datë 05.10.2013 deri në ora 12:00 . Sipas afatit të caktuar PZAP-i pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK ku theksohet se , ankesa e ushtruar kundër LDK në Ferizaj është e pa baze, nga fakti se asnjë dispozitë ligjore perfishire edhe Kodin e Mirësjelljes për Subjekt Politik mbeshtetës të tyre dhe kandidatet nuk e sanksionojn vendosjen e postareve para fillimit të fushatës zgjedhore theksohet në përgjigjen në ankesë .

PZAP-i shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës dhe gjeti se :

ankesa është e pa lejuar

Ankuesi në ankesën e tij pretendon se militantët e subjektit politik LDK kanë vendosur posterat e subjektit politik për kryetar komune në rrugët e ndryshme të hapësirave publike, pa lejen e organeve komunale dhe atë për shkak të fillimit të fushatës para kohës së zgjedhjeve .

Pretendimet ankimore se militantët e subjektit politik LDK kanë vendosur posterat e subjektit politik për kryetar komune në rrugët e ndryshme të hapësirave publike, pa lejen e organeve komunale dhe atë para datës së aktuar për fushatë zgjedhore. PZAP-i, nuk i shqyrtoi pretendimet ankimore sepse fillimi i fushatës zgjedhore para datës së caktuar për fushatë zgjedhore nuk është sanksionuar me LZP e as me rregulla zgjedhore në kuptim të dispozitës së nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe nenit 115.1 të LZP-së u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi .

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 154/13 më datën 05.10.2013

**Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi**



Këshillë Juridike : PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*